

PROGRAMI STUDIMIT “MASTER NE MESUESI NE BIOLOGJI - KIMI”

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Universitare Master i Shkencave në Mesuesi në Biologji - Kimi	
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Ne proces akreditimi	
Cikli i studimit	Cikli i dytë i studimeve	
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Shkencave të Natyrës , Institucion Publik, I Akredituar	
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip	
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite	
Forma e studimit	Me kohë të plotë	
Kushtet e pranimit	1. Pranimi i studentëve në këtë program studimi është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses një program të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” i cili jep akses në programet e ciklit të dytë në fushën e mësuesisë. 2. Kriter pranimi në këtë program të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: (<i>anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht</i>), në nivelin B₁, sipas akteve nënligjore të MAS-it. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.	
	Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë Universiteti “Eqrem Çabej”	a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor” në Biologji Kimi b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në programe studimi të përfafërta të cilat japin akses në fushën e mësuesisë .
	Nga Intitucione të tjera të Arsimit të Lartë	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor”, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimit të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë .
	Nga Institucione të Arsimit të Lartë jashtë vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor” në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehësimin pranë MAS-it .

	2. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës mesatare të ciklit të parë “Bachelor”, deri në plotësimin e kuotave të shpallura. Në rast se numri i aplikimeve kalon kuotën e parashikuar të pranimeve nga Njësia bazë, atëherë kandidatët do të seleksionohen sipas: a. Nivelit të përshtatshmërisë së diplomës “Bachelor” për vazhdimin e programit të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Mësuesi në Biologji Kimi”. b. Notës mesatare në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”.
--	---

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit *Master i Shkencave në Mësuesi në Biologji - Kimi* është program bashkëpunimi midis departamentesh. Realizohet me përgjegjësinë drejtuese të Departamentit **Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit** në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies të Universitetit “Eqrem Cabej”, Gjirokastrë. Ky program iniciohet mbi bazën e Vendimit të Grupit Qendror Nr. 2, datë 30.06.2023, Nr. 4079/1 Prot. “Për miratimin e lëndëve dhe krediteve për përafrimin e programeve të studimit në fushën e mësuesisë nga grupet e punës sipas profileve, në kuadër të urdhrit të ministrit për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë”, të ngritur nga MAS, në zbatim të pikës 4, të Nenit 83, të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe është një vazhdim dhe zgjerim i natyrshëm i programit përkatës ekzistues të ciklit të parë Bachelor në “Biologji-Kimi”, të Departamentit të **Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit** s, i cili në përfundim të tre viteve studimi të ciklit të parë jep Diplomë Bachelor në “Biologji -Kimi” i cili filloi në vitin akademik 2004-2005 me Vendim të MASH, datë 01.07.2004, Nr.4280 Prot.

Programi Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji -Kimi” synon në përgjithësi, në përgatitjen e plotë profesionale të studentëve si mësues të cilët do të shërbejnë në shkollat 9-vjecare dhe të mesme, dhe në veçanti aftësimin shkencor dhe didaktik të studentëve në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies së disiplinave në përputhje me format dhe teknikat bashkohore që përdoren në shkollë me qëllim përvetësimin aktiv dhe të qëndrueshëm të njohurive dhe vlerësimin e tyre në bazë të standarteve të arritjeve. Në këtë mënyrë, ky program synon ti japë arsimit 9-vjecare dhe të mesëm një potencial kuadrosh të arsimuar në

mënyrë të përshtatshme, duke modernizuar mësimdhënien dhe mësimin e Biologji-Kimise në përputhje me kërkimet dhe arritjet e reja në këto fusha.

Qëllimi i Programit përcaktohet dhe vlerësohet në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve shoqërore të vendit në përgjithësi dhe sistemit arsimor në vecanti, të nevojave të medha që dikton situata aktuale për mësues në shkencat e natyrës, si dhe në kuadër të zhvillimeve të vrullshme të teknologjisë së informacionit, e cila dikton nga ana e saj, objektiva dhe kërkesa të reja në sistemin arsimor të vendit.

Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

Objektivat formuese të programit të studimit synojnë:

- në përgatitjen e plotë profesionale të studentëve dhe formimin e tyre si mësues të biologjisë dhe kimisë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, duke u bazuar dhe mbështetur në ciklin e parë 3 vjeçar të studimeve universitare në Biologji-Kimi apo programe të përafërta me to, i cili ka realizuar formimin shkencor në këto drejtime.
- të pajisë të diplomuarit me njohuri, shkathtësi, shprehje dhe vlera praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës në mësuesi dhe sektorë të tjerë të administratës publike/jopublike dhe të përgatisë ata për karriera të mëtejshme respektive.
- të ofrojë mësimdhënie të ndërmjetme, duke integruar teorinë dhe praktikën që do të stimulojë të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe të zhvillojë potencialet e studentëve të tij përmes përjasjeve të të mësuarit ndërdisiplinor.
- të krijojë mundësitë për futjen e informacionit të ri nga Biologjia dhe Kimia, e cila do ta bëjë gjeneratën e ardhshme të specialisteve të aftë të mbështesë zhvillimet aktuale dhe të perspektivës kryesisht në arsim.
- të rritë kompetencat mësimdhënëse të departamentit dhe të studentëve për të ndërmarrë kërkime të përshtatshme, duke synuar dhe rritjen e rolit të universitetit si një qendër e kërkimit shkencor dhe kualifikimit të gjithanshëm në rajon.

Në përfundim të këtij programi të ciklit të dytë të studimit, Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji-Kimi”, me 120 ECTS, studenti do të marrë diplomë universitare me titull: Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji-Kimi”. Studentët që do të mbarojnë këtë program studimi, nuk do të fitojnë thjesht njohuri teorike mbi këto fusha, por nga vetë struktura e planit mësimor dhe programeve të lëndëve mësimore të parashikuara në të, do të fitojnë më tepër njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e

- **Mësuesit të Biologjise dhe kimise** në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.
- **Specialistit** në sektorë të ndryshëm të administratës publike apo private ku do të zgjidhin probleme me karakter administrativ duke iu përgjigjur më së miri kërkesave dhe zhvillimeve të sotme në fushën e biodiversitetit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Ky program është një vazhdim dhe zgjerim i natyrshëm i programit përkatës ekzistues të ciklit të parë Bachelor në “Biologji-Kimi”, të Departamentit të **Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit** s, i cili në përfundim të tre viteve studimi të ciklit të parë jep Diplomë Bachelor në “Biologji -Kimi”

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin e shkolles apo institucionit në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen kontigjenti i diplomuar në këtë program.

Programi i studimit Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji-Kimi” që çon drejt marrjes së Diplomës Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji-Kimi”, për realizimin e objektivave të tij, organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS): Për të fituar këtë diplomë nevojiten 120 kredite (ECTS).

- a. Studimet në UGJ zhvillohen në vite akademike. Struktura e vitit akademik përcaktohet me akt të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- b. Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka deri në 15 javë. Çdo javë ka 20 deri në 25 orë mësimore 50 minutëshe në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, praktikë në auditor, laboratorë. Brenda vitit akademik përfshihen dhe praktikat profesionale, provimet e lëndëve dhe teza e diplomës.
- c. Programi i studimit është i organizuar në lëndë, të cilat janë të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).
- d. Sasia e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.
- e. Vlerësimi i studentëve bëhet nga personeli akademik përkatës që zhvillon lëndët mësimore, i cili detyrohet të organizojë sipas gjykimit të tij kontrole me gojë, me shkrim, detyra të pavarura, punë laboratorike etj., në përputhje me mënyrat e vlerësimit të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit.
- f. Studenti përfundon studimet në këtë program studimi dhe merr diplomë kur ka likujduar me sukses gjithë lëndët mësimore të parashikuara në planin mësimor përkatës, ka mbrojtur punimin e diplomës dhe ka fituar 120 kredite (ECTS).
- g. Koha minimale për të përfunduar studimet në programin e studimeve “Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji-Kimi” është 2(dy) vjet.

VEPRIMTARITË FORMUESE

Sipas veprimtarisë formuese të tyre, plani mësimor organizohet në 6 grupe lëndësh:

- a. Lëndë bazë.
- b. Lëndë karakterizuese.
- c. Lëndë ndërdisiplinore/integruese.
- d. Lëndë plotësuese.
- e. Lende me zgjedhje
- f. Detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit “Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji-Kimi” përfshin 17 provime dhe punimin e diplomës..

Shpërndarja e krediteve sipas kategorizimit të lendeve që përmban plani mësimor:

- a. **Lëndë të formimit të përgjithshëm (baze) 26 kredite**
 1. Psikologji e zhvillimit dhe edukimit 6 ECTS
 2. Menaxhimi i klases 3 ECTS
 3. Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në Biologji dhe Kimi 8 ECTS
 4. Plotesime në Fiziologji dhe Njohuri plotësuese mbi natyrën. 9 ECTS
- b. **Lëndë të formimit karakterizues 43 kredite**
 1. Metodologjia e përgjithshme e mesimdhenies dhe të nxenit 7 ECTS
 2. Vlerësimi i të nxenit 6 ECTS
 3. Metodologjia e mesimdhenies së Biologjisë & Kimisë. Vlerësimi. 10 ECTS
 4. Probleme dhe ushtrime në Kimi dhe testime në Biologji. 10 ECTS
 5. Kurikula për arsimin e mesëm në Biologji dhe Kimi 6 ECTS
 6. Historia e zhvillimit të Kimisë dhe Biologjisë 4 ECTS
- c. **Lëndë ndërdisiplinore/integruese 25 kredite**
 1. Kurikula dhe arsimi gjithëpërfshirës 5 ECTS
 2. Metodatat e kërkimit në edukim 3 ECTS
 3. Edukim shëndetësor dhe Shëndeti mjedisor 6 ECTS
 4. Lëndë me zgjedhje 3 ECTS
 5. Kimi mjedisi 8 ECTS
- d. **Lëndë të formimit plotësues 12 kredite**
 1. Praktike shkollore e mesimdhenies 8 ECTS
 2. Gjuhë Angleze për qëllime specifike 4 ECTS
- e. **Detyrime përmbyllëse 14 kredite**
- f. Përgatitje për punim diplome 14 ECTS

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë “Bachelor” në *Biologji - Kimi* është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë ne programin e studimit “Master i shkencave ne Biologji - Kimi” është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Ne programin e studimeve Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji-Kimi”, procesi mësidhënës dhe didaktik përfshin metoda të ndryshme didaktike dhe teknika të ndryshme mësimdhënieje të cilat kontribuojnë në pjesmarrjen aktive të studenteve dhe në të mësuarin rezultativ. Ndër metodat kryesore që përdoren në lëndë mësimore të ndryshme, në varësi dhe të natyrës së tyre janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, detyrat dhe projektet e kursit, bashkebisedimi etj. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë e formimit të:

- **Mësuesit kontemporan të Biologjisë dhe kimisë** në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.
- **Specialistit** në sektorë të ndryshëm të administratës publike apo private ku do të zgjidhin probleme me karakter administrativ duke iu përgjigjur më së miri kërkesave dhe zhvillimeve të sotme në fushën e biodiversitetit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit *Bachelor ne Biologji - Kimi* mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë si “ Master profesional ne mesuesi ne Biologji- Kimi”, Master shkencor ne

mesuesi ne Biologji - Kimi, Master ne specialist per mbrojtjen e mjedisit, programe te tjera si Menaxher mjedisi, etj. apo në një fushë të ngjajshme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në keto programe te ciklit te dytë.

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t'u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë / mësues në fushën e shkencave te natyres / fushat e mbrojtjes se mjedisit, menzxhimit dhe ruajtjes se biodiversitetit te tij, të kualifikuar me njohuri të tilla si ne fushen e Biologjise, ne ate te Kimise, ne ate te mjedisit, ne ate te ruajtjes se biodiversitetit, etj. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Bachelor në mesuesi ne Biologji - Kimi është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës pasi plotesojne me sukses edhe ciklin e dyte te studimeve ne programin ne fjale..

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Si mesues te Biologjise dhe Kimise në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.
2. Specialist te ketyre fushave ne sektoret e administrates publike
3. Specialist te mjedisit ne sektorin shteteror dhe ate privat prodhues e ndertues.
4. Specialist per mbrojtjen e biodiversitetit, mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit
5. Specialist te mbrojtjes se pyjeve dhe faunes, etj.

Studimet në ciklin e dytë “Master i shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.

Departamenti përcaktojnë listën e temave për diploma në fillim të semestrit të tretë për ciklin e dytë të studimeve. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti.

Mbrojtja e diplomës bëhet në tri sezone: sezoni i dimrit, sezoni i verës dhe sezoni i vjeshtës. Kandidati në kërkim të mbrojtjes së diplomës I cili nuk kualifikohet në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sezonin pasardhës.

Drejtuesit e tezave të diplomës miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Departamenti përcakton listën e tezave në fillim të semestrit të parë të vitit të fundit të studimeve. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Psikologji e Zhvillimit dhe Edukimit	6	150	I
2.	Menaxhimi i Klases	3	75	II
3.	Metodologjia e pergjithshme e mesimdhenies dhe te nxenit	7	175	I
4.	Vleresimi i te nxenit	6	150	II
5.	Metodologjia e mesimdhenies se Biologjise & Kimise, vleresimi.	10	250	I, II
6.	Probleme dhe Ushtrime ne Kimi dhe testime ne Biologji	10	250	II
7.	Kurikula per arsimin e mesem ne Biologji dhe Kimi	6	150	I
8.	Historia e Zhvillimit te Kimise dhe Biologjise	4	100	I
9.	Kurikula dhe arsimi gjitheperfshires	5	125	II
10.	Metodat e kerkimit ne edukim	3	75	II
Lëndë me zgjedhje				
7.				
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Teknika e laboratorit dhe eksperimentit ne Biologji dhe Kimi	8	200	II
2.	Plotesime ne Fiziologji dhe Njohuri plotesuese mbi natyren	9	225	I
3.	Edukim Shendetesor dhe Shendeti Mjedisor	6	150	II
4.	Kimi Mjedisi	8	200	I
5.	Praktikë shkollore e mesimdhenies	8	200	I, II
6.	Gjuhe angleze per qellime specifike	4	100	II
Lëndë me zgjedhje (Zgjedh nje nga lendet e meposhteme):				
7.	A- Antroologji	3	75	II
	B- Aftesim ne teknologji kimike			
	C- Percaktues bimesh dhe kafshesh.			
8 .	Provim formimi / Punim diplome	14	350	II
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	
Total : viti I + viti II		180 ECTS		